



Lajmet e Fundit: Shkodër – Po ndërtonte pa leje një beach bar, vihet në pranga pronari i objektit



Lajmet

17/07/2021

Mirditë, Lezhë – Vijnë kontrollet e befasishme në akse rrugore, lokale dhe ambiente të ndryshme, për kapjen e personave në kërkim, të atyre që mbajnë armë zjarri dhe lëndë narkotike

Mirditë, Lezhë

Vijnë kontrollet e befasishme në akse rrugore, lokale dhe ambiente të ndryshme, për kapjen e personave në kërkim, të atyre që mbajnë armë zjarri dhe lëndë narkotike.

Gjatë kontrolleve, në qytet Rreshen u kap një 18-vjeçar që shpërndante lëndë narkotike në doza të vogla.

Gjatë kontrollit të ushtruar në banesën e 18-vjeçarit, shërbimet e Policisë gjetën dhe sekuestruan edhe një armë zjarri kallashnikov me një krehër me 30 fishekë luftarak.

Në zbatim të Planit të Masave të ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit “Për kontrollin e territorit, parandalimin e ngjarjeve kriminale, kapjen e autorëve të veprave penale, personave që mbajnë armë zjarri pa leje dhe personave në kërkim”, gjatë kontrolleve të ushtruara në gjithë qarkun Lezhë, specialistët e Seksionit të Hetimit të Krimit në Komisaratin e Policisë Mirditë arrestuan shtetasin K. N., 18 vjeç, banues në Mirditë.

Në qytetin e Rreshenit, shërbimet e Policisë gjatë kontrollit fizik i gjetën 18-vjeçarit doza me lëndë narkotike cannabis sativa që dyshohet se do t’i shiste në qytet .

Gjithashtu, gjatë kontrollit të ushtruar në banesën e tij, shërbimet e Policisë gjetën dhe sekuestruan në cilësinë e provës materiale një armë zjarri automatik me krehër me 30 fishekë.

Materialet hetimore iu referuan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kurbin, për veprat penale “Armëmbajtja pa leje” dhe “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”.



Share



Share



Share



Share



Email

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital



Download on the App Store

Arkiva

Select Month



Linqe

- > Arkiva
- > Akademia e Sigurisë
- > Ministria e Brendshme
- > Shërbimi Për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat
- > Interpol
- > Europol
- > Misioni PAMECA V
- > SCPA
- > Projekti Trivalent

◀ Berat – U kap duke transportuar 7 emigrantë të paligjshëm, vihet në pranga 1 shtetas

Interpol Tirana – Kapet në Spanjë dhe ekstradohet drejt Shqipërisë, një shtetas i dënuar me 10 vite burg ▶